

LITERATURE AND WAR IN LE CLÉZIO'S *WANDERING STAR* LETËRSIA DHE LUFTA NË ROMANIN *YLLI ENDACAK* TË LE CLÉZIO-S

Dëfrim SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI², Besa SALIU³

^{1*} Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

² Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje

³ High School of Music „Todor Skalovski - Tetoec” - Tetovo

*Corresponding author e-mail: defrim.saliu@unite.edu.mk

Abstract

Literature and war have, since antiquity, maintained a close relationship; the first work that describes war is Homer's *The Iliad*. At a more perfect level, in the early Middle Ages we encounter *The Song of Roland* which marks the birth of a new literary era during the longest period of human history, the Middle Ages. As a very important experience in writing a novel or literary work, war not only provides a stately material to writers, it also impels them to ask about the warrior, his motivations and passions. War literature oscillates between two opposing poles, on the one hand is its cause, heroism, and the exaltation of war, the other being the horrors and humiliations that war brings.

The whole story of the *Wandering Star* begins in the southern Alps in the summer of 1943 in a small village in the inner circle of Nice, where all Jewish families that were persecuted by the Italian fascists and German Nazis were gathered. Le Clézio had borrowed the subject of the novel (the oldest part of this story) from the memories of his mother, that reappeared to her in 1982, during the Beirut bombings. The author finished the novel in 1987, but he delayed the publication to avoid a direct link to the then-current events of the 1990s in the Middle East.

Keywords: Literature, war, *Wandering star*, Le Clézio.

Përmbledhje

Letërsia dhe lufta, që nga antikiteti kanë mbajtur marrëdhënie të ngushta. Vepra e parë që përshkruan luftën është *Iliada* e Homerit. Në një nivel më të përsosur, në fillim të Mesjetës, e kemi *Këngën e Rolanit* që shënon lindjen e një epoke të re letrare në periudhën më të gjatë të historisë së njerëzimit që është Mesjeta. Si një përvojë shumë e rëndësishme gjatë shkrimit të një romani apo vepre letrare, lufta nuk u siguron shkrimtarëve vetëm një material madhështor, por, ajo gjithashtu i shtyn të pyesin rreth luftëtarit, motivimet dhe pasionet e tij. Letërsia e luftës lëkundet midis dy poleve të kundërta, nga njëra anë është kauza, heroizmi dhe lartësimi i luftës, kurse nga ana tjetër janë tmerret dhe poshtërsitë që i sjell lufta.

E gjithë historia e romanit *Ylli endacak* fillon në Alpet jugore, në verën e vitit 1943, në një fshat të vogël në brendësi të Nicës, vend ky, ku ishin grumbulluar të gjitha familjet hebreje që përndjekeshin nga fashistët italianë dhe nazistët gjermanë. Subjekti i romanit Le Clézio e kishte huazuar (pjesën më të hershme) të kësaj historie nga kujtimet e nënës së tij, të cilat iu rishfaqën asaj në vitin 1982, gjatë bombardimeve të Beirutit. Autori e mbaroi romanin në vitin 1987, por ai e vonon botimin për të shmangur një lidhje të drejtpërdrejtë me ngjarjet aktuale të viteve '90 në Lindjen e Afërt.

Fjalët kyçe: Letërsia, lufta, *Ylli endacak*, Le Clézio.

1. Hyrje

Romani *Ylli endacak* (Étoile errante) është shkruar nga Le Clézio në vitin 1992. Historia e romanit bazohet në rrëfimet e nënës së tij për golgotën të cilën e kishte përjetuar gjatë Luftës së Dytë Botërore (Michel, 1993, 279-285). Romani është i ndarë në pesë pjesë, ku çdo pjesë ka një protagonist të romanit:

- pjesa e parë: *Helena*,
- pjesa e dytë: *Esteri*,
- pjesa e tretë: *Nejma*,
- pjesa e katërt: *Fëmija e diellit*
- pjesa e pestë: *Elizabeta*.

Romani paraqet një poetikë të dyfishtë të cilën Le Clézio e shpjegon gjatë marrjes së çmimit letrar *Nobel* (Le Clézio, 2008). Në këtë roman Le Clézio e sheh veten si një dëshmitar sipas traditës sartriane, kurse nga ana tjetër ai kërkon të shkojë përtej çarjeve socio-historike, për të skicuar në mënyrë më të përafërt figura mitike dhe utopike në roman (Eliade, 1996, 65). Romani na zhyt në mendime të universit romantik me një rëndësi të veçantë historike që ndodh gjatë Luftës së Dytë Botërore.

2. Lufta si protagonizëm i romanit

Pjesa e parë e romanit titullohet sipas protagonistes *Hélène Grève*, e cila gjatë kohës së nazizmit përdor emrin e rremë Esther, emër i sajuar nga babai i saj për t'i ikur përndjekjes së ushtrisë gjermane. Romani fillon me përshkrimin e natyrës gjatë verës së vitit 1943 në Alpet jugore në një fshat të vogël të quajtur Saint-Martin-Vesubie, në zonën e prapme të Nicës ku ishin mbledhur të gjitha familjet hebreje të Francës, por edhe të shteteve tjera si Polonisë, Gjermanisë dhe Rusisë (Le Clézio, 2001, 9). Në këtë fshat ata qëndruan një kohë të gjatë, përshkak të ikjes dhe depërtimit nga ana e ushtrisë gjermane në kampet e përqendrimit (Visoka, 2016, 136).

Ky fshati malor ishte nën vëzhgimin e ushtrisë italiane, deri sa Italia nënshkroi marrëveshjen e armëpushimit. Familjen hebreje në fjalë, vera e vitit 1943 e gjen në Saint-Martin-Vesubie. Protagonistja e romanit, Esther, ishte trembëdhjetë vjeçe, me flokët e saja të zeza, kaçurrela, të prera shkurt si dhe me fytyrë të nxirë nga dielli. Babai i saj quhej Michel Grève, ndërsa nëna Elizabeth Grève. Babait të saj i pëlqente ta thërriste me emrin e saj spanjoll, Estrellita apo ylli i vockël. Ajo tërë ditët i kalonte bashkë me shokët e saj, duke u endur në fushat e mëdha me bar sipër fshatit, në vendet që ishin të panjohura për të.

Ishte fillimi i qershorit. Meqë mësuesi Seligman ishte i sëmurë dhe nuk mund të zhvillonte mësimin, shkolla e fshatit ishte e mbyllur për një kohë të caktuar. Pushimet kishin filluar dhe do të ishin të gjata për fëmijët. Ata nuk e dinin se këto pushime për disa prej tyre do të mbaronin me vdekje. Esther-i bashkë me babain e saj kishte shëtitur malet përreth dhe ai i kishte treguar se në fund të lugajës, ku malet ishin të ngjeshura njëri pas tjetrit, ishte Italia. Ushtarët italianë të cilët i mbanin nën vëzhgim familjet hebreje qëndronin në hotelin *Terminus*, një godinë e madhe e bardhë. Pjesën më të madhe të ditës ushtarët e kalonin në sallën e madhe të ngrënies, kurse kur bënte kohë e mirë ata dilnin jashtë (Le Clézio, 2001, 12).

Hebrenjtë, një herë në ditë duhej të zinin radhë para hotelit, për të regjistruar praninë e tyre dhe për të marrë letrat e racioneve. Esther-i gjatë kësaj periudhe shoqërohej prindërit e saj. Babai i Esther-it nuk i urrente italianët, sepse ata i kishin shpëtuar nga gjermanët. Mësuesi Seligman e kishte regjistruar Esther-in bashkë me fëmijët e tjerë hebrej për të marrë mësimet fetare, por babai i saj nuk kishte pranuar. Ai nuk kishte bindje të fortë fetare dhe i kishte thënë Esther-it se fëmijët shumë shpejt do të lodhen dhe nuk do ta ndjekin mësimin fetar.

Mësuesi tjetër në fshat ishte Heinrich Ferne i cili banonte në një vilë të vjetër dhe luante në piano. Kur nuk kishte mësim, ai luante në piano, muzika e të cilit dëgjohej në tërë fshatin. Kur kishte ardhur në fshat, kapiteni i karabinierëve Mondolini, që ishte ithtar i muzikës kishte dashur që t'ia marrë atij pianon për ta dërguar në hotelin *Terminus*, ku ai qëndronte. Zotëri Ferne iu kishte thënë se ata mund ta merrnin pianon, meqë konsideroheshin si fitimtarë, porse ai vetë nuk do të luante kurrë në piano për ta (Le Clézio, 2001, 12).

Një pasdite, Esther-i shkoi te shtëpia e zotëri Ferne-s, hyri pa bërë zhurmë në kuzhinë, për të mos e shpërqëndruar derisa ai po luante në piano. Kur ai e pa, papritmas se ajo kishte hyrë brenda, e pyeti për emrin e saj, por pa mos e prishur magjinë e tingujve që ai i kombinonte për bukuri. Pasi e kreu pjesën e nisur, zotëri Ferne i ofroi asaj mundësinë që ta mësonte si si t'i lëviz gishtat e vogël mbi sustat e fildishtë të pianos. Që nga ajo pasdite, Esther-it sapo i jepej rasti shkonte të mësojë të luajë në piano te zotëri Ferne. Esther-i kishte bërë shumë shokë, por ndër të preferuarit e saj ishte Tristan-i, një djalë anglez i cili banonte bashkë me të ëmën e tij në hotelin *Victoria*.

Familja e tij kishte jetuar një kohë në Cannes, babai i tij kishte qenë tregtar në Afrikën Ekuatoriale, por që nga fillimi i luftës nuk dinin asgjë për të. Nëna e tij zonja O'Rourke ishte një grua e bukur që e fliste gjuhën frënge shumë pastër. Sipas fjalëve të vajzave, ajo ishte një spiune në shërbim të karabinierëve, dhe se ajo ishte një kriminele që kishte ardhur për t'u fshehur (Le Clézio, 2001, 19). Shoku tjetër i Esther-it ishte Gasparini me të cilin një ditë shkojnë te kushëriri i tij në Roquebillière që kositnin grurin. Bashkë me gjyshin e Gasparini-t me një karrocë arritën në fushat e korrjes së grurit.

Në këto fusha punonin djemtë e rinj dhe gratë me shami në kokë që lidhnin duajt e grurit, para se t'i nxirrnin në rrugën e karrocës. Pasi që e mblidhnin grurin, italianët merrnin ndonjë kallëz gruri që kishte mbetur, sepse në fshatrat e tyre nuk kishte grurë. Kuptohet që ishte kohë lufte dhe transporti i grurit në viset malore ishte i vështirë. Gasparini i tregoi se babai i tij kishte dal në mal për t'i ndihmuar partizanët italianë. Ai e pyeti Esther-in se ku është babai i saj, ajo u përgjigj se edhe ai ka dalur në mal dhe u ndihmon hebrenjve që të kalojnë malet për t'u fshehur nga ushtria gjermane (Michel, 1993, 281).

Pastaj e pyeti se çfarë ka punuar para lufte, ajo i tregoi se ishte profesor i historisë dhe gjeografisë në lice. Shojja tjetër e Esther-it ishte Rachel, një vajzë e bukur me flokë të kuqe. Në lidhje me të, njerëzit e fshatit thoshin se Rachel-a dilte natën pa pyetur për ndalim-qarkullim dhe shkonte lahej krejt lakuriq në lumë. Vajzat thoshin se ishte e dashura e kapitenit të karabinierëve, Mondolini-t dhe kështu që kur të mbaronte lufta asaj do t'ia prisnin flokët e bukura dhe do ta pushkatonin, si të gjithë spiunët e Gestapos (Le Clézio, 2001, 27).

Esther-i dhe Rachel-a, si dy shoqe qëndruan gjatë të ulura mbi gurët e lagur afër lumit. Rachel-a e nxori pakon e cigares dhe filloi të tregoj ëndrrat e saja pasi të mbaronte lufta. Ajo do të merrej me muzikë si zotëri Ferne, të luante me piano, të këndojë dhe të shkonte në qytete të mëdha si Vienë, Paris, Berlin, kudo nëpër botë. Shëtitjet e Esther-it në natyrë ishin të përditshme, ajo bashkë me Gasparini-n shëtitnin livadhet që ishin afër Roquebillière. Një ditë, Gasparini erdhi dhe e kërkoi Esther-in në shtëpi. Derën ia hapi nëna e Esther-it, Elizabeth-a. Nëna e saj e thiri të ulet dhe të pret Esther-in. Ajo i ofroi Gasparini-t një shishe me lëng qershie që e kishte përgatitur në pranverë.

Ai kërkoi nga Elizabeth-a që të marr Esther-in të premtën në kishë për festën e Shën Mërisë. Ceremonia siç ishte parashikuar u zhvillua të premtën, statuja e Shën Mërisë do të lërë kishën dhe do të kthehet në mal. Në Saint-Martin Vesubie vinin njerëz nga i gjithë rajoni, një ndër ta ishte Mario, një djalë me flokë të kuqe si të Rachel-ës të cilin Esther-i e donte shumë. Mario lodhej aq shumë sa kur vinte në fshat menjëherë e zinte gjumi. Një ditë në mëngjes bashkë me Esther-in dolën të shëtitnin rreth fshatit. Mario i tregoi se nuk donte të merrte pjesë në anën e italianëve, por të qëndronte në vendlindje si bari.

Fashistët në shenjë hakmarrje ia vrasin të gjitha delet dhe qenin e tij, atëherë Mario kishte dalur në mal. Një pasdite në kuzhinën e hotelit *Terminus* erdhën disa burra që i vunë mbi tryezë letrat e identitetit për të gjithë, për Esther-in, babain dhe nënën e saj, por edhe për Mario-n (Visoka, 2011, 103). Në një copë kartoni që mbante fotografinë e babait të saj shkruante: Michel-Pierre Joffre i lindur më 10 prill 1910 në Marseille, pastaj vinte karta e nënës Madelaine Leroy, i martesës Joffre e lindur më 3 shkurt 1912 në Morbihan, dhe karta e identitetit të Esther-it me të dhënat e Hélène Joffre, e lindur më 22 shkurt 1931 në Nicë.

Gjatë kësaj bisede mes burrave dhe babait të saj dëgjoi një emër të Angelo Donati. Angelo Donati në Livorno të Italisë kishte përgatitur një anije të madhe me vela dhe me motor që do t'i merrte të gjithë hebrenjtë dhe do t'i çonte në Jeruzalem, sa më larg gjermanëve. Ishte fundi verës, natyra dhe koha po ndryshonin në Saint-Martin Vesubie, pas shpërthimit dhe vetëvrasjes së Mario-s me lëndë shpërthyes, njerëzit nuk ishin më ata që kishin qenë. Gasparini e takon një ditë Esther-in dhe e njofton se së shpejti kanë për të ardhur gjermanët dhe ata do t'i merrnin me vete të gjithë hebrenjtë (Le Clézio, 2001, 46).

Esther-i i tha se do ta merrnin edhe atë, ndërsa Gasparini i tha jo se emri Hélène nuk është emër hebre. Jo nuk quhem Hélène, por quhem Esther dhe Esther është emër hebre. Ai u zotua se po erdhën gjermanët do ta fsheh Esther-in në plevicë. Tashmë, gjermanët ndodheshin shumë pranë, Gasparini i kishte parë në mbrëmje nga ana e Bertemontit, sepse italianët e kishin humbur luftën dhe do të dorëzoheshin. Atëherë gjermanët do të pushtonin të gjitha fshatrat, gjithë malin. Për këto ngjarje të gjithë fshati ishin mbledhur në shesh dhe bisedonin për këto gjëra dramatike që i pritnin ditët në vijim.

Vëmendja e Esther-it ishte ta takonte Rachel-ën, por djemtë dhe vajzat tregonin se Rachel-a ishte zemëruar me prindërit e saj dhe tanimë jetonte në hotel me kapitenin Mondolini. Të shtunën, më 8 shtator, Esther-in e zgjoi nga gjumi një zhurmë e madhe, që dëgjohej në çdo cep të fshatit. Nëna e saj Elizabeth-a i tregoi se babai ishte larguar, dhe nuk donte t'ia prishte gjumin (Le Clézio, 2001, 62). Ishte zhurma e avionëve amerikanë që shkonin drejt Gjenovës, kjo do të thonte se italianët e kishin humbur luftën dhe do të largoheshin nga Saint-Martin Vesubie.

Esther-it i ra menjëherë në mendje, se tash do të vinte ushtria gjermane. Lufta nuk ka mbaruar i tha nëna e saj Elizabeth-a, tash ne duhet të nisemi që mos na kapin gjermanët. Esther-i u vesh me rroba të trasha dhe këpucë të mira, se po i priste një udhëtim i gjatë nëpër Alpet gjatë kohës së vjeshtës, ku e dinte se çfarë moti do të bëjë ditët dhe netët në vijim. Ushtarët italianë ishin para hotelit, duke pritur sinjalin e nisjes. Dielli kishte filluar të përvëlonte, ishte momenti i mirë për të nisur udhëtimin, së pari u nisën kamionët me ushtarët italianë, pastaj njerëzit apo hebrenjtë që ishin mbledhur rreth zotit Seligman. Grupi i njerëzve ecte në rrugë me gurë, me bar, atje ku shëtiste Esther-i bashkë me babain e saj. Rreth mbrëmjes iu afruan pyllit, koha filloi të ftohet.

Esther-i e shtrëngoi për dore nënën e saj dhe ishte hera e parë që i kalonte këto shtigje të pjerrta malore gjatë natës. Ndërkohë Esther-i e pyeti nënën e saj se kur do të na bashkohet babai, a do të kthehemi përsëri këtu, apo nisemi për të mos u kthyer më kurrë këtu (Le Clézio, 2001, 72). Gjatë udhëimit, Esther-i mendonte se ç'kishte ndodhur me Rachel-ën. Rachel-a kishte qëndruar në fshat, sepse i kishte prindërit e sëmurë. Pasi që ishin larguar të gjithë, në fshat u dëgjua zhurma e kamionëve. Rachel-a doli me nxitim në shesh të shoh se çka ka ndodhur, kur e pa para hotelit ushtarin që rrinte në këmbë dhe ai ishte gjerman.

Ishin ditët e gjata dhe të pafundme të dimrit në Festiona. Esther-i bashkë me nënën e saj punonin në pensionin *Passageri*, në këmbim të ushqimit dhe të një dhome në katin e parë. Ajo merrej me të gjitha punët e pensionit, me përjashtim të therrjes së lepujve që ishte ushqimi kryesor në listën e gjellëve të pensionit. Zonja e shtëpisë Angela, ishte edhe e dashura e zotit *Pasaggeri* (Le Clézio, 2001, 89). Esther-i e shoqëronte çdo ditë Angela-n gjatë blerjeve dhe furnizimit me ushqime si qumësht, zarzavate, vezë, nganjëherë ndonjë lepur të gjallë.

Dimrin e kaluan në Festiona, çdo natë dëgjoreshin të shtëna armësh, ata ishin partizanët italianë. Djaloshi që e shoqëronte Esther-in në Festiona ishte Brao. Brao ishte një pesëmbëdhjetëvjeçar, që ishte rritur në azilin e fëmijëve. Në pranverë Esther-i bashkë me Brao-n shëtitnin përreth lumit Stura i cili në pranverë ishte një lumë shumë i madh. Në shtratin e lumit Sturës kishte ishuj, aty kishin mbirë pemë, bari ishte i lartë. Ishte fundi i verës, kur Brao njoftoi se gjermanët po niseshin drejt Veriut. Esther-i u gëzua se do të kthej në Saint-Martin Vësubie, por Elisabeth-a i tha se do të ktheheshin në Francë, pasi çdo gjë kishte mbaruar. Por, Esther-it mendja i qëndronte te Tristan-i, Rachel-a dhe zoti Ferne. Edhe njëherë kishte dëshirë ta vizitonte Saint-Martin Vësubie. U nis rrugës për t'i takuar partizanët italianë dhe të marr ndonjë lajm për babain e saj. Para një viti e kishte kaluar këtë rrugë bashkë me nënën, dhe e mbante mend çdo cep të kësaj luginë (Le Clézio, 2001, 102).

3. Rrugëtimi drejt tokës së premtuar

Pjesa e dytë romanit është *Esther-i*. Esther-i është shtatëmbëdhjetë vjeçë dhe bashkë me nënën e saj gjenden në Port d'Alon në dhjetor të vitit 1944. Pas Festionës, Elisabeth-a dhe Esther-i u kthyen në Paris, pa babain e saj. Ata në Paris i pret një mik i afërt i babait, Simon Rubeni. Në fillim i strehoi në garazh, sepse nuk ishte i sigurt se kishte mbaruar lufta, pastaj i vendosi në apartamentin e tij në rrugën Gravijë (Le Clézio, 2001, 107). Ai u thoshte që duhet të niseni që të harroni, kjo nënkuptonte të harrojmë vdekjen e babait.

Simon Rubeni i përcolli në stacionin e trenit në Paris, ku Esther-i bashkë me nënën e morën linjën Paris-Marsej. Kur i përshëndeti ai ia dha Elisabeth-ës adresën e vëllaut të tij nëse i ndalon policia. Në Marsej arritën në mesnatë, pastaj duhej të vazhdonin me trenin për në Tulon. Prej Tulonit me tren për në Port d'Alon ku në bregun e këtij vendi do t'i priste një anije italiane (Visoka, 2016, 139). Me të arritur në plazh, të gjithë njerëzit u ulën dhe e pritnin anijen italiane *Sette Fratelli*, që nënkuptonte shtatë vëllezërit apo shtatë fëmijët e Jakobit. Kjo anije mbarte fatin e tyre. Të gjithë njerëzit ulen në gjuhë dhe i luteshin Zotit ose qanin nga gëzimi.

Nga anija zbritën dy marinarë dhe u ndihmojnë njerëzve që ngjiten sa më shpejt në anije. Njerëzit u futën në pjesën e poshtme të anijes që të mos vëreheshin nga doganierët. Sa filloi udhëtimi, një erë e fuqishme e lëvizte anijen, saqë të ikurit menduan se do të gjejnë vdekjen në mes të oqeanit, pas atij rrugëtimi të gjatë me vite. Ëndrra e Elisabeth-ës ishte që të shkonin në Kanada, sepse e kishte ëndërr të jetonte në këtë vend me dëborë, pyje, shtëpi prej druri buzë lumenjve të pafundëm.

Në mëngjes arrijnë në Port-Manin, ku kontrollohen nga doganierët me motobarka të doganës. Pas kontrollimit doganierët, e ndalën anijen *Sette Fratelli* dhe zbarkuan njerëzit dhe i drejtuan drejt Tulonit, për t'i futur në burg. Të gjithë i mbyllën në një sallë të madhe dhe dy ditë pasi që i mbyllën në këto salla, i pushtoi një dëshirë e madhe për të parë detin. Ditët kalonin, njerëzit thoshin se do të na nxirrnin në gjyq dhe do t'i kthenin në Paris. Në vizitë u erdh avokati për t'i parë në burg, ai mbërriti herët në mëngjes, me një çantë plot me letra dhe qëndroi në sallë një pjesë të madhe të ditës (Le Clézio, 2001, 142).

Avokati u premtoi se së shpejti do të jenë të lirë dhe se do të vazhdonin rrugëtimin e tyre. Anija *Sette Fratelli* u nis në mëngjes dhe në mbrëmje do të ishin në Itali, në La Spezia. Të nesërmën pasi që lanë Italinë, në mbrëmje iu afruan Qipros. Anija aty i ndali motorët së punuari dhe i lëshoi velat për të mos bërë zhurmë për arsye se këtë ishull e kishte nën kontroll ushtria angleze e cila kishte burgosur mijëra njerëz, që pastaj t'i kthenin në Francë, Itali, Gjermani apo në Poloni. Kur kaluan Qipron, të gjithë dolën në kuvertë të gëzuar për shpëtimin dhe festonin. Të nesërmën anija *Sette Fratelli* u gjet në brigjet e Eretz Israhëlit. Më 14 maj në mëngjes, njerëzit filluan të mblidhen në sheshin e Zhafas, për të vazhduar udhëtimin mëtej (Le Clézio, 2001, 158). Atë ditë kamionët do t'i çonin njerëzit në Jeruzalem.

Në kamionë kishte hebrenj nga e gjithë Europa, kur kamionët hynë në Tel-Aviv, dielli shëndriste. Ata u ndeshën me një kolonë me njerëz që ecte në drejtim të kundërt, drejt Haifasë. Vendi i parë kur ndaluan ishte fshati Latrun, ku zbritën për t'u freskuar. Pastaj vazhduan udhëtimin, Esther-i disa herë e hapte mushamën e kamionit dhe vërente gra arabe të cilat ecnin në drejtim të kundërt. Ajo zbriti për t'i pyetur se ç'ndodhte, por gratë e kthenin shpinën dhe i bëritnin me fjalë të ashpra në gjuhën e tyre. Një vajzë e re doli nga turma, drejt Esther-it dhe nxori nga xhepi i saj një fletore dhe shënoi emrin e saj *Nejma*, i zgjati Esther-it që të shënoj emrin e saj dhe u largua bashkë me turmën. Esther-i vazhdoi ta ndjek, por kamioni u nis, ndërsa ajo mund ta fshinte nga mendja fytyrën e Nejma-ës (Le Clézio, 2001, 164).

4. Kampi i refugjatëve si pjesë e romanit

Pjesa e tretë e romanit *Nejma*. Në këtë pjesë Nejma e cila gjendet në kampin e refugjatëve që janë larguar nga qytetet arabe, që njëhej si kampi i Nur Shamsit. Në verën e vitit 1958, Nejma së bashku me Aamma Huriye dhe Saadi Abu Talibi që më vonë do të jetë burri i saj, e përshkruan jetën e tyre në këtë kamp. Në kamp i kishin sjell me kamion të Kombeve të Bashkuara të gjithë të larguarit nga vendet që zhvillohej lufta. Dy herë në javë po vinte kamioni me ushqim si miell, qumësht dhe biskota *Maria*, sa më shumë rritej intensiteti i luftimeve kamionët me ushqim e rrallonin ardhjen e tyre.

Nejma në këtë kamp kishte ardhur me kamion të Kombet e Bashkuara me mushama që bënin transportimin e të mbijetuarve gjatë luftës. Ajo kishte jetuar në qytetin Akka që ishte në breg të Detit Mesdhe. Babai i saj Ahmadi, para se të nisej për në luftë, që zhvillohej në veri të vendit, e kishte mësuar Nejma-n që të lexojë dhe të shkruaj. Shumica e banorëve të kampit të Nur Shamsit vinin nga malet, dhe jeta e vështirë për ata në fillim ishte normale (Le Clézio, 2001, 177). Me vonesën e ardhjes së ndihmave ushqimore, me mungesën e ujit në pusët që gjendeshin afër kampit për arsye të mosrënies për një kohë të gjatë të shiut, jeta dita ditës po vështirësohej.

Aamma Huriya që Nejma i thoshte teze erdhi disa ditë pas Nejma-s në kamp, ajo erdhi nga al-Kudsi. Aamma Huriya u vendos në të njëjtën kolibe ku jetonte vetëm Nejma, me vete kishte një makinë për qepje me të cilën derisa kishte fije për të arnuar rrobat e pjesëtarëve tjerë në kamp (Visoka, 2011, 110). Këtë punë e bënte në këmbim të ushqimit, cigareve, sepse para ja në këtë kamp nuk vlente për asgjë. Aamma Huriya tregonte histori të ndryshme të cilat i kishte dëgjuar dhe përjetuar gjatë jetës, kjo e bënte që në kasollë të mblidheshin për të dëgjuar të gjithë fëmijët e kampit. Në fund të verës në kamp erdhi Rumija që ishte shtatëzëne më shumë se gjashtë muaj. Ajo ishte një vajzë e re që ishte e mbuluar me perçe.

I shoqi i Rumija-s kishte vdekur, si dhe gjithë anëtarët tjerë të familjes. Atë e sollën ushtarët pasi që e kishin marrë nga spitali ushtarak pas një qëndrimi të gjatë. Në fillim ajo ishte shumë e turpshme dhe nuk e hiqte aspak ferexhen, as edhe brenda shtëpisë. Por, Aamma Huriya me përvojën e saj dita ditës e zbuti Rumija-n, duke ushqyer çdo ditë, i fliste ngadalë, e ledhatonte, pak nga pak e solli në jetë përsëri. Saadi që ishte një bari, u vendos në kodrën me gurë ku ishte varrosur plaku Nas, aty ndërtoi një strehë me degë të vjetra dhe qëndronte tërë ditën dhe natën, duke shiquar me sytë nga rruga e Tulkarmit (Le Clézio, 2001, 187).

Ai ishte një bari që kishte lindur në al-Muzhib ku kishte ruajtur dhitë më parë. Lufta e kishte sjell në këtë kamp, pas humbjes së kontakteve me pjesën tjetër të familjes. Saadi ishte dashuruar në Nejma-n dhe çdo ditë vinte te streha ku jetonte dhe bisedonte me të. Kur erdhi dimri jeta në kampin Nur Shamsit u vështirësua. Nejma i mbushi dy vite që kishte ardhur në kamp. Nga kequshqyerja Aamma Huriya filloi të dobësohet, ndërsa Rumija dilte nga streha vetëm për të kryer nevojat e saja. Një ditë në mëngjes Rumija shkoi të marrë ujë te përroi, ku aty i filluan dhimbjet e lindjes, ndërsa Nejma ishte në maje të kodrës bashkë me Saadin. Ajo vrapoi menjëherë dhe e thirri Aamma Huriya-n që t'i ndihmonte që të lindur.

Nuk kishin mundur që ta bartnin dhe t'a dërgonin në strehë. Nejma i mori çarçafët dhe ia ofroi Aamma Hurija-s. Ishte hera e parë që shihte një lindje, dhe për Nejman sa ishte e frikshme aq edhe e bukur. Rumija shtrëngonte buzët pa nxjerrë zë dhe mundohej që të shtyj fëmijën që të dal jashtë trupit, dhe fëmija doli ndërsa Rumija u rrëzua ngadalë mbi tokë (Le Clézio, 2001, 202). U shfaq ajo qenie, mbështjellë me gjak dhe placentë, Aamma Hurija ia preu kordonin dhe filloi të lajë foshnjën e cila lëshoi britmën e saj të parë. Ishte një vajzë shumë e bukur, disa gra sollën batanije dhe ato e morën Rumija-n dhe e dërguan në strehë duke e mbart ngadalë, si një princeshë. Jeta në strehën e Nejma-s ndryshoi, tash ato kishin një bebe që ishte bebja e parë që kishte lindur në kamp.

Të gjithë u ofronin ushqim apo dhurata, si sheqer, ndërresa të pastra, pak qumësht pluhur, dru të thata për zjarr, rrënjë, barëra ermues etj. Edhe Rumija kishte ndryshuar shumë pas lindjes së vajzës, emrin i vajzës ishte Lula që do të thotë al-marra al lula apo ishte e para herë. Ditët e dimrit e bënin të vështirë jetën në kamp. Në kamp nga mungesa e ushqimit u paraqit edhe sëmundja e murtajes (Visoka, 2016, 142). Në fillim u paraqitën minjtë që ngordhnin në rrugët e kampit. Fëmijët duke luajtur me minjtë e ngordhur u infektuan dhe pastaj ato filluan të vdisnin. Kjo murtajë do t'i marr jetën Rumija-s dhe Aamma Hurija-s (Le Clézio, 2001, 211).

Duke parë situatën e keqe Saadi bashkë me Nejma-n e përgatitën një bohçe me bukë, miell, shkrepsë, kripë, shumë kuti qumshti për Lula-n. Pastaj e lidh në shpinë Lulën e vogël dhe largohen nga kampi. Ato ecnin çdo ditë nga lindja e diellit deri në mbrëmje. Kur u mbaroi qumshti Nejma i kërkoi Saadit që duhet patjetër të gjejë qumësht, përndryshe fëmija do të vdiste. Saadi u nis në kërkim të ushqimit dhe e la vetë Nejmen për dy ditë. Nejma mendoi se ai nuk kthehet më dhe do të vdiste nga uria bashkë me Lulën e vogël. Pas dy ditëve, në mbrëmje, erdhi Saadi bashkë me një dhi dhe kecin e saj.

Saadi e moli dhinë dhe i dhanë qumësht Lula-s së vogël, pastaj edhe ato konsumuan qumësht nga dhia dhe për herë të parë i erdhi shpresa për të jetuar, dhe tha ndër vete se tash nuk do të vdesim më. Atë natë të ftohtë, të ngopur nga qumështi i dhisë, ata kaluan bashkë një natë të lumtur duke bërë dashuri për herë të parë në jetën e tyre pas sa kohë që ishin njohur. Ecnin çdo ditë nëpër kodra dhe lugina derisa arritën në detin e Lotit, liqenin e madh të kripur. Aty ishte al-Muxhibi, lugina e fëmijërisë së Saadi-t. Saadi lidhi litarin e dhisë për kyçin e dorës dhe që bashku me Nejma-n dhe Lula-n filluan të ecin rrugës së Amanit (Le Clézio, 2001, 220).

5. Fillimi i një jete të re

Pjesa e katërt e romanit është *Fëmija i diellit*. Në vitin 1950 Esther-i arrin në Ramat Johanan në veri të Israelit, si punëtore në kibuc që ishte fermë kolektive apo koloni në Izraelin modern. Esther-i punonte në plantacionet e molleve dhe ishte fillimi i dimrit. Jacques-u, i fejuari i saj, kishte shkuar në luftë në frontin sirian nga ana e Tiberiadës. Sa herë që i jepnin leje ai vinte në vizitë në Ramat Johanan për të takuar Esther-in. Ajo do të martohej me Jacques-un në pranverë sapo të kthehej nga lufta, për ta martesë nuk kishte shumë rëndësi apo ishte vetëm një rit. Gjatë netëve të shabbat-it dhe muzikës me fizarmonikë, Jacques-u dhe Esther-i mbasi kishin bërë dashuri qëndronin njëri afër tjetrit dhe thurinin plane për të ardhmen. (Le Clézio, 2001, 224).

Jacques-u donte të studionte për mjekësi dhe do të shkonin në Kanada, në Vankuver. Elizabeth-a nëna e Esther-it punonte në repartin e pastrimit, për të larë dhe arnuar rrobat e punës. Me Esther-in punonte edhe Nora. Ajo ishte italiane dhe kishte humbur të gjithë familjen nga Livorno që i kishin vrarë fashistët italianë. Të dyja punonin, herë pas herë linin punë për t'u çlodhur duke pirë cigare. Ato kishin një vend të fshehtë që ishte një dhomë në ndërtesën e rezervuarit të ujit, ku strehoheshin pasdite kur bënte shumë vapë. Aty Nora recitonte poezi të Garcia Lorkës, Majakovskit, Dantes, Petrarkës, Pavezës, etj.

Një mëngjes kur mësoi Esther-i për herë të parë se priste një fëmijë, kuptoi se i kishte ndodhur diçka që më parë nuk e kishte përjetuar. Atë ditë doli të shëtis nëpër fusha dhe lëndina dhe i rikujtonte planet e Jacques-ut. Kur u kthye në shtëpi, pa se para shtëpisë ishin mbledhur shumë njerëz. Erdhën dy ushtarë që sollën lajmin se Jacques-u ishte vrarë në kufi pranë liqenit të Tiberiadës. Esther-i nuk tha asnjë fjalë, vetëm mendoi se ai nuk do të kthehet, nuk do ta shohë të birin. Pas marrjes së lajmit për vdekjen e Jacques-ut, Esther-i në fund të marsit që mos merrte vesh për fëmijën nëna e saj Elizabeth-a, ajo udhëton me një anije të Kombeve të Bashkuara për Marsejë (Le Clézio, 2001, 235).

Pastaj nga Marseja me anijen që transportonte emigrantë niset për në Kanada, ku vendoset në Montreal, regjistrohet në Universitetin Mac Gill dhe do të studiojë mjekësi ashtu siç donte Jacques-u. Muajt e fundit të shtatëzanisë ajo kishte ndjekur leksione në mjekësi, por për arsye të shtatëzënisë i kishte ndërprerë. Në shtator i lind djali i saj që e pagëzon me emrin e babait të saj Michel.

6. Rikthimi në vendlindje

Pjesa e pestë e romanit *Elizabetha*. Kjo pjesë i kushtohet nënës së Esther-it, Elizabeth-ës. Në verën e vitit 1982 Esther-i kthet pas 40 viteve në Nicë. Arsyeja e kthyerjes është vdekja e nënës së saj në vendin ku ka kaluar vitet e rinisë bashkë me burrin e saj Michel, dhe vendi i lindjes së Esther-it. Në Nicë, Elizabeth-a kishte ardhur qysh në vitin 1973 gjatë luftës në shkretëtirën e Sinajit, atë vit kur Esther-i sapo ishte martuar me Filipin dhe kishte hapur kabinetin e konsultimeve pediatrike. Elizabeth-a u nis e veshur me tesha të zeza, me një valixhe të vogël ashtu siç kishte ardhur me anije në Jeruzalem pas Luftës së Dytë Botërore. Esther-i e kishte lutur që të qëndronte bashkë me të dhe Filipin, dhe se djali i saj apo nipi Michel kishte nevojë për Elizabeth-ën.

Por, vendosshmëria e saj kishte qenë më e fortë dhe kur kishte hipur në aeroplan i kishte thënë Esther-it se nuk largohet prej këtij për t'u kthyer përsëri, por largohet përgjithmonë. Qëndrimi i saj në Nicë, ecja rrugëve për të cilat kishte dëgjuar nga rrëfimet e babait të saj, vizita e liceut ku babai i saj kishte dhënë mësim, ulliri i mbjellur nga babai i saj në kopshtin e liceut si simbol i paqes, e kthejnë atë në kujtimet e fëmijërisë që i kaloi në Saint-Martin-Vèsubie gjatë viteve të luftës (Le Clézio, 2001, 250). Elizabeth-a ishte e shtrirë në spital dhe çdo ditë i tregonte pambarim të njejtë histori Esther-it, duke i kujtuar qytetet si Piza, Roma, Napoli, Amantea, qytete që i kishte vizituar bashkë me burrin e saj para luftës. Zëri i saj dita ditës po bëhej më i dobët. Ajo vdiq gjatë natës.

Të nesërmen Esther-i mori trupin e saj dhe e dërgoi në krematoriun në furrën e nxehur prej tetëqind gradëve ku trupi i Elizabeth-ës për disa minuta u shndërrua në një grush hiri. Në një cilindër hekuri e futi hirin e trupit të nënës së saj dhe e mori e futi në çantën e saj. Ditët në vijim ajo e shëtiste nëpër Nicë, duke kujtuar çdo vend, pallat apo ngjarje që kishte lënë mbresa në kujtesën e saj. Të dielën pas vdekjes së Elizabeth-ës, e merr autobusin për Saint-Martin-Vèsubie. E gjen këtë fshat në një formë organizimi krejt ndryshe nga ashtu siç e kishte lënë në vitin 1945. E kërkoi hotelin, ku dikur qëndronin ushtarët italianë, i cili ishte shëndruar në një pushimore për turistët. Shtëpia e zotit Ferne gjithashtu ishte shëndruar në një pavion pushimesh, e vetmja gjë që e njohu ishte druri i vjetër i manit në kopsht.

Tash fshati kishte pamje tjetër dhe njerëzit që i njihte Esther-i, shumica kishin vdekur, ndërsa të rinjtë ishin larguar. Në fshat kishte turistë të huaj që shëtitnin me fëmijë të tyre dhe qentë. Esther-i dëshironte të vizitonte Bertemonte, që ishte vendi ku kishte vdekur apo pushkatuar nga ushtarët e Gestapos babai i saj Michel. Vizitoi livadhet që kishte shëtitur me Tristan-in, vendin ku luanin lojrat e tyre të dashurisë nëpërkat dhe shumë kujtime të tjera të fëmijërisë që i kishte kaluar në këtë fshat.

Në mbrëmje kthehet në Nicë, për arsye se të nesërmen do të vinin në Nicë, Filipi dhe Michel-i djali i saj, që së bashku pastaj do të merrnin trenin për Paris, Londër, apo dikund tjetër për të harruar. Nga çanta që këto ditë nuk e kishte hequr nga krahu, e nxjerr cilindrin me hirin e trupit të Elizabeth-ës dhe shkon në vendin me bar apo shpatet e Bertemontes ku kishte vdekur babai i saj dhe rrotullohet me gjithë forcë, e hap kapakun e cilindrit dhe era që frynte e merr me vete hirin dhe mbart. Pastaj kutinë e zbrazët e hedh larg në det sa që i detyron peshkatarët ta kthejnë kokën (Le Clézio, 2001, 267).

7. Përfundimi

Romani *Ylli endacak* është roman që përshkruan historinë e jetës së nënës së Le Clézio-s gjatë Luftës së Dytë Botërore. E mira e këtij romani se nuk përfundon me nota tragjike. Humbja historike është një sprovë që u mundëson të mbijetuarve ta njohin çmimin e lirisë, pas peripecive që i kalon gjatë kohës së luftës. Jeta e kaluar gjatë kohës së luftës është aq mizore, por jeta pas luftës poashtu u mundëson t'i rigjejnë vlerat e botës së vërtetë.

Le Clézio sjell në jetë historinë e personazheve. Romani nuk tregon ngjarje historike, por më tepër jetën e personazheve, më saktë personazhet që vuajnë nga lufta. Vendet janë reale, por historia e treguar nuk ka ndodhur. Kjo nuk do të thotë se ngjarjet e rrëfyera janë joreale. Është një histori ende aktuale sot që ka të bëjë me konfliktet etnike dhe fetare, mjerimin e të refugjatët, lufta dhe fati i individit. Ata gjithashtu kanë përgjegjësinë e një fëmije.

Tragjedia për Esther-in është vdekja e Jacques-ut në luftë, i njëjti fat kur ajo ishte një vajzë e vogël, babai i saj ishte viktimë e përleshjes. Përkundrazi, është fati i Nejma-s. Le Clézio nuk i tregon lexuesit se çfarë po ndodh me Nejma-n. Ajo mbetet një yll endacak. Kur dy gratë rrëfejnë, shpesh është një përshkrim i situatës, gjërat që panë, dëgjuan dhe nuhatën në atë kohë – pa analizoni situatën.

Referencat

- [1]. Clézio, J.-M. G. (1992). *Étoile errante*. Paris: Gallimard.
- [2]. Clézio, J.-M. G. (2001). *Ylli endacak*. Tiranë: Albin.
- [3]. Cortanze, G. d. (2009). *J. M. G. Le Clézio*. Paris: Gallimard.
- [4]. Eliade, M. (1996). *Mythes, rêves, mystères*. Paris: Gallimard.
- [5]. Eliade, M. (2019). *Miti dhe realiteti*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- [6]. Jauss, H. R. (1978). *Pour une esthétique de la réception*. Paris: Gallimard.
- [7]. Michel, J. (1993). Épreuves du livre. Réflexions sur *Étoile errante* de J. M. G. Le Clézio. *Les Lettres romanes* no. 47, 280.
- [8]. Millet, C. (1997). *Le Légendaire au XIX siècle, poésie, mythe et vérité*. Paris: PUF.
- [9]. Roussel-Gillet, I. (1999). *J. M. G. Le Clézio, écrivain de l'incertitude*. Paris: Ellipses.
- [10]. Salles, M. (1999). *Étude sur Le Clézio : Désert*. Paris: Ellipses.
- [11]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*. Prishtinë: 99-AIKD.
- [12]. Visoka, A. (2016). *Shkrim dhe receptim*. Prishtinë: Faik Konica.